



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 627 Akti

Nr. 577 Vendimi
Tiranë, më 21.10.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datën 20.10.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Luljeta Kole**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Luljeta Kole, e cila kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Subjekti i rivlerësimit Luljeta Kole ushtron detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 15.12.2020 dhe do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli kryesuese, Valbona Sanxhaktari anëtare dhe Olsi Komici relator, ndërsa vëzhgues ndërkombëtar u caktua z. Ferdinando Buatier De Mongeot.
- 3.** Me vendimin e datës 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Luljeta Kole, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe rivlerësimin e aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike¹ mbi përbërjen e trupit gjykues dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit, nëse do të kishte, me ndonjë nga anëtarët e trupës.
- 4.** Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
- 5.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
- 6.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
- 7.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Luljeta Kole, si dhe njoftimin e tij për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet

¹Subjekti u njoftua po në datën 15.1.2021 me e-mail.

e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 7.10.2022² mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht zhvilluar nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 14.10.2022. Subjekti i rivlerësimit, brenda këtij afatit të lënë nga Komisioni, dërgoi me postë elektronike prapësimet e tij.

9. Subjekti i rivlerësimit në datën 14.10.2022 u ftua në seancën dëgjimore, e cila do të zhvillohej më 20.10.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0 (*underground*), Tiranë.

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 20.10.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit Luljeta Kole u paraqit personalisht dhe parashtrroi shpjegimet dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Luljeta Kole ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

13. Për subjektin e rivlerësimit Luljeta Kole, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. ILDKPKI-ja³, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të

²Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë në rrugë elektronike.

³Raporti nr. *** prot., datë 19.4.2018, i ILDKPKI-së.

rivlerësimit Luljeta Kole, e cila është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2003, me nr. Indeksi ***, duke konstatuar se:

Në përfundim të veprimeve verifikuese, ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje pasurie;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

16. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacionet e marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njoftohen rezultatet e hetimit mbi pasuritë e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

Mbi pasuritë e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë *Vetting*

1. Apartament banimi me sipërfaqe 88 m², në zotërim, ndodhur në Lagjen *, rr. “****”, p. ***, h. ***, ap. ***, Korçë, pronë e cila figuron në bashkëpronësi të bashkëshortit dhe prindërve të tij.** Subjekti nuk zotëron pjesë takuese, kurse bashkëshorti zotëron 25%. Burimi i krijimit: blerë me privatizim në vitin 1993 dhe nuk është bërë rivlerësim në ASHK.

1.1 Apartamenti është deklaruar nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti A. K., në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2008 (në vijim DIPP), me pjesë takuese 25%.

1.2 Subjekti, bashkë me deklaratën *Vetting*, ka depozituar kontratën për privatizimin e banesës, datë 3.6.1993, të lidhur ndërmjet Ndërmarrje Komonale Banesa Korçë (në vijim NK Banesa) dhe shtetasve J., J., Th. dhe A. K.⁴ për apartamentin 2+1, nr. ***, shk. ***, kati ***, i ndodhur në Blv. “****”, ku do paguhej shuma prej 18,736 lekësh. Për këtë apartament është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie datë 30.12.2011, i regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve J., J., Th. dhe A. K., me ¼ pjesë takuese secili.

⁴J. (babai i bashkëshortit), J. (nëna e bashkëshortit), Th. (motra e bashkëshortit).

1.3 Komisioni, me pyetësin standard, i ka kërkuar subjektin të shpjegojë se ku ka banuar nga momenti që ka marrë detyrën.

Subjekti ka shpjeguar se nga fillimi i detyrës në vitin 1992 deri në martesë në vitin 1996 ka jetuar së bashku me prindërit, motrën dhe vëllain e saj në banesë shtetërore me qira nga NK Banesa, në adresën: Lagjja ***, rr. “****”, nr. ***, Korçë. Pas martesë, nga viti 1996 e deri aktualisht, subjekti deklaroi se jeton me familjen e saj dhe prindërit e bashkëshortit në adresën: Lagjja ***, rr. “****”, p. ***, h. ***, ap. ***, Korçë.

1.4 Në lidhje me kumatën e saj Th. K. (E.), meqenëse figuronte bashkëpronare në apartamentin me sip. 88 m², subjekti ka shpjeguar se ajo ka qenë në trungun familjar me prindërit dhe vëllain e saj (bashkëshortin e subjektit) dhe ka jetuar me ta në apartamentin në bashkëpronësi të tyre deri në shkëputjen për shkak të martesës në datën 9.11.1995. Në vazhdim, subjekti shpjegon se nuk ka jetuar me kumatën, pasi martesë e saj ka qenë e mëvonshme (datë 17.4.1997). Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues certifikatën e trungut familjar dhe atë të martesës për shtetasen Th. K., ku rezulton se është shkëputur nga trungu familjar i origjinës në datën 9.11.1995.

1.5 Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK), Drejtoria Vendore Korçë⁵, nuk ka konfirmuar pasuri të regjistruar në emër të subjektit Luljeta Kole, ndërsa konfirmon të regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve A., J., J. dhe Th. K. pasurinë apartament, me sip. 88m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në Blv. “****”, Korçë. ASHK-ja ka bashkëlidhur edhe praktikën e privatizimit të këtij apartamenti.

1.6 Komisioni ka konstatuar se subjekti ka deklaruar adresë të ndryshme banimi në deklaratat periodike⁶ dhe i ka kërkuar subjektin shpjegime me pyetësin nr. 2. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në të gjitha rastet bëhet fjalë për të njëjtën adresë banimi vetëm se emërtimi i saj ka ndryshuar në vite dhe si dokument provues ka depozituar vërtetimin⁷ e Bashkisë Korçë, e cila konfirmon ndryshimet e këtyre adresave ndër vite.

1.7 Furnizuesi i Shërbimit Universal (në vijim FSHU)⁸ nuk konfirmon kontratë të furnizimit të energjisë elektrike lidhur me subjektin e rivlerësimit Luljeta Kole dhe as me personat e lidhur me të (A., J. dhe D. K.) J. Th. dhe J. K.

1.8 Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a.⁹ (në vijim UKK) konfirmon se shtetasit Luljeta, A., J., D. dhe J. K. nuk rezultojnë klientë të këtij institucioni, ndërkohë që konfirmon një abonent me emrin J. K., me kontratë nr. ***, në adresën: Lagjja ***, rr. “****”, obj. ***, h. ***, k. ***, ap. ***, Korçë, por nuk konfirmohet se është i njëjti person me shtetasin J. K. K., babai i bashkëshortit.

⁵Përgjigje nr. *** prot., datë 4.3.2021, të Drejtorisë Vendore Korçë.

⁶Në DIPP-të e viteve 2003 - 2009 ka deklaruar: Lagjja ***, Blloku ***, p. ***, shk. ***, ap. ***, Korçë; në DIPP-të e viteve 2011 - 2016 ka deklaruar: Lagjja ***, rr. “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Korçë; në kontratën e privatizimit të vitit 1993 deklarohet Blv. “****”, p. ***, shk. ***, banesa nr. ***, Korçë.

⁷Bashkia Korçë, me nr. *** prot., datë 29.8.2022.

⁸Përgjigje nr. *** prot., datë 18.2.2021, e FSHU-së.

⁹UKK-ja, me nr. *** prot., datë 19.8.2022.

1.9 Komisioni, për të shuar çdo hije dyshimi për ndonjë pasuri tjetër të padeklaruar nga subjekti në bashkëpronësi të bashkëshortit dhe babait të tij J. K., me pyetëtorin nr. 3 i ka kërkuar subjektit që të vërtetojë se shtetasi J. K., i konfirmuar si abonent nga UKK-ja, nuk është i njëjti person me J. K. K. (vjeherri i subjektit).

Subjekti i rivlerësimit, bazuar në informacionin e përcjellë nga Bashkia Korçë¹⁰, konfirmon se nga verifikimi në regjistrin e shtetasve rezultojnë dy shtetas në qytetin e Korçës: shtetasi J. K. K., i datëlindjes 28.12.1935, banues në Lagjen ***, rr. "****", p. ***, h. ***, ap. *** (që është vjeherri i subjektit); dhe shtetasi J. P. K., i datëlindjes 27.9.1961, banues në Lagjen ***, rr. "****", p. ***, h. ***, ap. ***. Shtetasi J. K., banues në rrugën "****", nuk është i njëjti person me shtetasin J. K., banues në rrugën "****", Korçë.

Subjekti ka depozituar gjithashtu, në cilësinë e provës, faturë të energjisë elektrike (korrik 2022) në emrin J. K. (sipas deklaramit të subjektit është pasqyruar gabim mbiemri, pra duhet Kole dhe jo Kola), me adresë: "****", R., Korçë, si dhe faturë e ujit (korrik 2022) në emrin J. K., me adresë: Lagjja ***, rr. "****", obj. ***, h. ***, k. ***, ap. ***, Korçë.

1.10 Komisioni ka konstatuar se nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti A. K., nuk është deklaruar pjesa takuese prej 25% në apartamentin e përfutur nga privatizimi në DIPP-të e viteve 2003 - 2007 dhe për këtë qëllim i ka kërkuar subjektit shpjegime.

Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se raporti i pjesëve takuese për bashkëpronarët të përfutur që në privatizimin e apartamentit ka qenë i njëjtë dhe nuk ka ndryshuar. Mosdeklarimi i pjesës takuese është gabim në plotësimin e deklaratave i ardhur si pasojë e paqartësisë në lidhje me mënyrën e plotësimit të tyre dhe në asnjë rast nuk ka pasur qëllim për fshehje pasurie.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse. Mosdeklarimi nga ana e subjektit dhe bashkëshortit të saj i pjesës takuese 25% në apartamentin që bashkëshorti ka në bashkëpronësi me familjarët e tij vlerësohet se është një pasaktësi në deklaram dhe nuk ka pasur qëllim për fshehje pasurie. Subjekti, këtë pasaktësi e ka rregulluar duke e deklaruar pjesën takuese të bashkëshortit në deklaratën *Vetting*.

Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi në deklaram, në kuptim të germës "a", pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, nuk arrin në atë nivel sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masë disiplinore në lidhje me kriterin e pasurisë.

2. Gjendje cash jashtë sistemit bankar në shumën 1,200,000 lekë. Burimi i krijimit: kursime nga të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100%.

2.1 Bazuar në deklaramet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni kreu analizën e ecurisë së likuiditeteve *cash* ndër vite, shtesave/pakësimeve, me qëllim verifikimin e gjendjes së

¹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 13.9.2022, e Bashkisë Korçë, drejtuar subjektit.

mundshme të këtyre likuiditeteve në fund të vitit 2016, në raport me verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të bërë në deklaratën *Vetting*.

2.2 Nga deklaramet periodike të pasurisë¹¹, referuar shtesave dhe pakësime ndër vite, nga përlllogaritjet rezultoi se gjendja *cash* në monedhën lekë më 31.12.2016 është në shumën 1,400,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* (datë 30.1.2017) gjendja është 1,200,000 lekë.

2.3 Komisioni ka analizuar edhe mundësitë financiare të burimit të krijimit të gjendjes *cash* dhe nga analiza financiare për periudhën 2008 – 2016 duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet, krijuar pasuritë dhe kursimet *cash*, pasi për këtë periudhë rezultati financiar rezulton me balancë pozitive.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika në lidhje me gjendjen *cash* të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*.

3. Automjet tip “Renault Clio”, regjistruar në emër të bashkëshortit, blerë në vitin 2011 në vlerën 300,000 lekë. Nuk është deklaruar burimi i krijimit. Pjesa takuese: 50%. Subjekti ka deklaruar “në bashkëpronësi si pasuri e vënë gjatë martesës”.

3.1 Automjeti tip “Renault Clio” është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2011 si automjet i regjistruar në emër të bashkëshortit me pjesë takuese 50%, por pa përcaktuar burimin e krijimit.

3.2 Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së automjetit, datë 1.11.2011¹², me shitës Dh. L. dhe blerës A. K., me vlerë 300,000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.

3.3 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR)¹³ konfirmon të regjistruar në emër të shtetasit A. K. automjetin tip “Renault Clio” i vitit 1999, me targa ***, përfitur nga kontrata e shitjes datë 1.11.2011, referuar më lart¹⁴.

Në lidhje me burimin e krijimit të këtij automjeti

3.4 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti A. K. nuk ka deklaruar burimin e krijimit të blerjes së automjetit tip “Renault Clio” në deklaratën *Vetting* dhe as në DIPP-në e vitit 2011.

3.5 Komisioni vëren se nga leximi i DIPP-së për vitin 2011 nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar pakësim të kursimeve *cash* të krijuara nga të ardhurat familjare ndër vite, të ardhura të cilat sipas deklaramit kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e automjetit. Sipas

¹¹Në DIPP/2008 subjekti ka deklaruar: “Kursime të krijuara nga pagat gjatë gjithë vitit të padepozituara në banka, pjesa 50%. Vlera: 200,000 lekë”; në DIPP/2010: “Kursime nga të ardhurat vjetore, pjesa 50%. Vlera: 200,000 lekë”; në DIPP/2013: “Gjendje *cash* të kursyera nga të ardhurat e familjes, pjesa 50%. Vlera: 300,00 lekë”; në DIPP/2014: “Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, kursime nga të ardhurat nga paga, pjesa 50%. Vlera 200,000 lekë”; në DIPP/2015: “Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, kursime nga të ardhurat nga paga, pjesa 50%. Vlera: 200,000 lekë”; në DIPP/2016: “Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, kursime nga të ardhurat nga paga, pjesa 100%. Vlera: 300,000 lekë”.

¹²Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 1.11.2011.

¹³Përgjigje nr. ***, e DPSHTRR-së.

¹⁴Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se shitësi Dh. L. e ka blerë këtë automjet në datën 16.10.2011 në Bullgari, në çmimin 971.50 euro dhe paguar doganën në shumën 28,936 lekë në datën 21.10.2011.

deklarimeve periodike kursimet *cash* të akumuluarra deri më 31.12.2010 janë në shumën 400,000 lekë, e mjaftueshme kjo për të përballuar pagesën e çmimit prej 300,000 lekësh.

3.6 Pavarësisht për sa konstatohet më sipër, nga analiza financiare për vitin 2011 duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar shpenzimet jetike dhe çmimin e automjetit prej 300,000 lekësh në datën 1.11.2011.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë në DIPP-në e vitit 2011 dhe atë *Vetting*, përgjatë hetimit dhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se është thjesht harresë dhe pasaktësi në plotësimin e këtyre deklaratave.

Burimi i krijimit të kësaj pasurie janë kursimet nga të ardhura të përbashkëta të siguruara nga puna e saj dhe e bashkëshortit. Sikurse edhe Komisioni ka konstatuar në analizën financiare të vitit 2011 është vërtetuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë zotëruar të ardhura të mjaftueshme për të paguar çmimin e këtij automjeti.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse. Mosdeklarimi i burimit të krijimit të automjetit tip “Renault Clio” në DIPP-në e vitit 2011 dhe atë *Vetting* konsiderohet pasaktësi në deklaram. Gjithashtu, bazuar edhe në analizën financiare të vitit 2011 kur ky automjet është blerë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj i kanë pasur mundësitë financiare për kryerjen e këtij investimi me të ardhurat e krijuara prej tyre gjatë punës ndër vite.

Komisioni vlerëson se pasaktësia në deklaram, në kuptim të germës “a”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, është e karakterit minimal dhe nuk vlerësohet se arrin deri në atë masë sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e pasurisë.

KONSTATIME TË TJERA

4. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 73.7 m², të ndodhur në Korçë, të blerë nga prindërit dhe vëllai, ku pagesat për shlyerjen e kredisë (që ka shërbyer për blerjen e apartamentit) janë bërë pjesërisht nga subjekti

4.1 Subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin standard, ka deklaruar se prej fillimit të detyrës në datën 26.11.1992, deri në martesë në datën 15.9.1996, ka jetuar së bashku me prindërit, motrën dhe vëllain në adresën: Lagjja ***, rr. “****”, nr. ***, Korçë. Banesa ka qenë pronë shtetërore për të cilën ka qenë lidhur kontratë qiraje në emër të babait Th. T. me NK Banesa. Duke qenë se kjo pronë i është kthyer ish-pronarit me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, familja e babait ka marrë statusin si e pastrehë e kategorisë së parë, me vendimin nr. ***, datë 21.6.1996, të Këshillit Bashkiak Korçë.

4.2 Bashkia Korçë¹⁵ ka vënë në dispozicion të Komisionit vendimin e Këshillit Bashkiak të vitit 1996, ku është miratuar lista e përfituesve nga kredia me kushte lehtësuese me interes 0%, e personave të kategorizuar si të pastrehë, ku përfitues është edhe familja e shtetasit Th. N. Tr.

4.3 Banka Kombëtare Tregtare¹⁶ (në vijim BKT) ka vënë në dispozicion praktikën e kredisë së përfituar me kushte lehtësuese, të konkretizuar me kontratën e kredisë së datës 17.11.2010, me kredimarrës Th. dhe M. T. (babai dhe vëllai i subjektit) dhe dorëzanës Th. T., Xh. T., Luljeta Kole dhe shoqëria “***” sh.p.k., ku jepet shuma 2,875,000 lekë me 0% interes, me qëllim blerje shtëpie. Sigurimi i kredisë do bëhet me anë të hipotekimit të apartamentit me sip. 73.7 m², i ndodhur në z. k. ***, Korçë, e regjistruar në emër të shoqërisë “***” sh.p.k., i cili do të blihet nga familja T.

Nga dokumentacioni i bankës rezultojnë e depozituar kontrata premtim shitje e datës 6.9.2010¹⁷ e lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe blerës Th. e M. T., për apartamentin me sip. 73.7 m², me çmimin 44,000 euro. Në momentin e çeljes së kredisë do paguhet shuma prej 14,000 euro ose 2,800,000 lekë, e cila do likuidohet nëpërmjet kredisë nga BKT dhe diferenca do likuidohet brenda muajit korrik të vitit 2011.

Është depozituar kontrata e shitblerjes, datë 3.12.2012¹⁸, për këtë apartament po me të njëjtat palë, si dhe është lëshuar dhe certifikata për vërtetim pronësie datë 6.12.2012, në pronësi të shtetasve Th., Th., M. dhe Xh. T. me pjesë takuese ¼.

4.4 BKT-ja¹⁹ ka vënë në dispozicion informacionin mbi llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultojnë se për periudhën 2010 – 2015 subjekti Luljeta Kole ka bërë pagesa për këstet e kredisë (së marrë nga babai dhe vëllai i saj në vitin 2010) për vitet:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Totali
Pagesa/lekë	12,700	130,000	168,500	163,300	66,000	7,000	547,500

Pagesat janë bërë nga Luljeta Kole për Th. T. në shuma mujore 12,000 lekë, jo në mënyrë të vazhdueshme. Pagesa të tilla janë bërë edhe nga babai i subjektit Th. T.

4.5 Komisioni, nisur nga pagesat e bëra nga subjekti i rivlerësimit, për të verifikuar qëllimin për të cilin janë bërë, si dhe për të shuar çdo dyshim për pasuri të padeklaruar për të cilat subjekti mund të ketë pjesë në bashkëpronësi, me pyetësorin nr. 2 i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ajo është një kredi e marrë nga babai për blerjen e një apartamenti në të cilin ai aktualisht jeton me nënën. Të gjitha këstet e kredisë janë paguar me të ardhurat e familjes së babait dhe subjekti thjesht ka shkuar në bankë për të bërë pagesën në emër të tyre si kredimarrëse. Kjo ka ndodhur për faktin se prindërit e saj janë në moshë të thyer, ndërkohë që ajo ishte i vetmi person që mund të kujdeset për ta pasi jetojnë vetëm (vëllai me familjen e tij

¹⁵Bashkia Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 23.8.2022.

¹⁶BKT, me shkresën nr. *** prot., datë 23.8.2022.

¹⁷Kontratë premtim shitje nr. *** prot., datë 6.9.2010.

¹⁸Kontratë shitblerje nr. *** prot., datë 3.12.2012.

¹⁹BKT, me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2021.

prej vitit 2004 jeton në Amerikë, kurse motra me familjen e saj prej vitit 2003 jeton në Greqi) Pagesat janë kryer nga subjekti sa herë që ata nuk kanë pasur mundësi për t'i kryer vetë (për shkak të gjendjes shëndetësore, motit, largësisë së bankës nga banesa etj.).

Komisioni nuk konstatoi problematika apo dyshime në lidhje me pagesat e bëra nga subjekti i rivlerësimit, pagesa këto të bëra për shlyerjen e kredisë së marrë nga familja e saj.

Edhe në rast se këto pagesa do të vlerësoheshin si shpenzime të subjektit të rivlerësimit, ato nuk do të kishin efekt negativ në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

5. Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe asaj *Vetting* për periudhën e hetimit 2003 – 2016, të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasuritë.

Periodha	Para 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	18,736	0	0	-70,788	31,570	9,431	259,626	267,138	343,224	327,807	-455,847	294,575	319,408	178,431	253,491
Apartament banimë sip. 8m2, L.7, Rruga*****	18,736														
Autoveture Renault Clio, blerw 2011_****										300,000					
DIFERENCE LIKUIDITETI (LIK. AKTUAL - LIKUIDITETE VITI PARAAAR	0	0	0	-70,788	31,570	9,431	259,626	267,138	343,224	27,807	-455,847	294,575	319,408	178,431	253,491
LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT	0	0	0	-70,788	-39,218	-29,787	229,839	496,977	840,202	868,009	412,162	706,737	1,026,145	1,204,576	1,204,576
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	0	0	0	-70,788	-39,218	-29,787	229,839	496,977	840,202	868,009	412,162	706,737	1,026,145	1,204,576	1,458,067
DETYRIME	0	0	0	148,639	-3,484	-45,155	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kredi NBG 120,000 dt.21.7.2005 (principal)				98,639	-53,484	-45,155									
Kredi Fondi Besa 24.4.2007 50,000 lekë me afat 10 muaj (FB1)				50,000											
Kredi Fondi Besa 16.7.2008 50,000 lekë me afat 12 muaj (FB2)				50,000											
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	18,736	0	0	-219,427	35,054	54,587	259,626	267,138	343,224	327,807	-455,847	294,575	319,408	178,431	253,491
TE ARDHURA dokumentuar	4,041,679	898,386	1,446,670	1,509,335	1,563,549	1,796,839	1,643,835	2,043,263	1,920,713	2,001,941	1,574,248	1,841,400	2,413,426	2,576,926	2,454,838
Të ardhura nga paga si gjuqtare Gj.Rr.Korçë	2,710,604	476,877	889,616	920,685	965,198	959,576	850,335	1,092,814	1,091,687	1,105,172	1,103,373	1,183,252	1,388,407	1,554,219	1,390,855
Të ardhura nga mësimdhënia , Korçë								125,786							
Të ardhura nga paga e b/sh Këshilli i Qarkut	354,297	225,651	336,660	345,146	346,325	350,055									
Të ardhura nga paga e b/sh pranë ***, Korçë						211,722	498,016	501,735	491,712	543,321	103,771				
Të ardhura nga paga e b/sh pranë ***												278,249	641,081	639,530	638,496
Të ardhura nga pensioni J. 1991-2016	481,930	99,516	115,964	126,300	127,724	145,268	155,870	169,484	177,114	187,080	194,322	201,012	199,612	195,743	235,363
Të ardhura nga pensioni J.1993-2016	494,848	96,342	104,430	117,204	124,302	130,218	139,614	153,444	160,200	166,368	172,782	178,887	184,326	187,434	190,124
SHPENZIME	2,550,638	563,184	675,858	888,218	759,548	1,468,061	825,879	826,579	819,720	888,870	906,144	910,165	1,428,038	1,437,882	1,477,316
Shpenzime jetike	2,368,456	563,184	563,184	657,342	657,342	1,415,808	819,720	819,720	819,720	819,720	846,144	846,144	1,319,988	1,345,656	1,410,552
Shpenzime udhëtimi	82,182	0	12,674	6,127	0	24,182	6,159	6,859	0	69,150	0	14,021	63,050	92,226	6,764
Shpenzime interesi + penalitete krede				8,949	13,506	3,771									
Shpenzim krede NBG				120,000											
Shpenzim këst krede FB1				45,800	8,700										
Shpenzim këst krede FB2				30,000	24,300										
Shpenzim krede (destinacioni)				50,000	50,000										
Shpenzime mobilimi	100,000		100,000								60,000	50,000	45,000		60,000
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	0	0	0	-70,788	-39,218	-29,787	229,839	496,977	840,202	868,009	412,162	706,737	1,026,145	1,204,576	1,458,067
Cash							200,000	200,000	400,000	400,000	400,000	700,000	900,000	1,100,000	1,400,000
Llogari page në Union Bank _L_K_****								70,110	210,988	237,273	13,575	5,922	74,258	97,282	55,553
Llogari rrjedhëse të lidh. me dep në Union Bank _L_K_****															
Llogari depozite Union Bank _L_K_****															
Llogari kursimi Union bank _L_K_****								100,851	102,682	104,545	0	0			
Llogari personale plus Union Bank _L_K_****_EUR														0	
Llogari page RBAL_AK				-70,878	-39,218	-30,095	0								
Llogari OTP _JK													102	0	
Llogari krede ABI(ish NBG)_AK				90	0	73	73	73	73	73	73	73	73	73	73
Llogari për kalim pensioni BKT J. K												141	498	2,463	1,826
Llogari për kalim pensioni BKT J. K												237	556	2,490	614
Llogari page Credins _L_K								125,786	125,786	125,786	0				
Llogari page Credins _A_K															
Llogari ISPB _D.+L.															
Llogari ISPB _J.K_****						235	29,766	157	673	331	-1,487	-161			
Llogari ISPB _J.K_****												0			
Llogari ISPB (ish Vebeto) ****_A_K												525	50,658	2,268	0
Analiza dokumentuar	1,472,305	335,202	770,812	840,544	768,948	274,191	558,330	949,547	757,769	785,264	1,123,951	636,660	665,980	960,613	724,032

B. KONTROLLI I FIGURËS

6. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, me shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2022, ka dërguar pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit Luljeta Kole, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 8.9.2022, të KDZH-së dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se:

i) Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

ii) Për subjektin e rivlerësimit Luljeta Kole nuk administrohen prova, informacione konfindenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Luljeta Kole.

6.1 Nga përditësimi i informacionit me institucione të tjera ligjzbatuese, Komisioni ka vijuar hetimin në lidhje me kriterin e figurës, nga ku është konstatuar si më poshtë vijon:

a. Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë²⁰ dosjen gjyqësore me të pandehur shtetasin S. P., akuzuar për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të policisë dhe rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal. Nga dokumentacioni në dosje rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë kërkesën për gjykim për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të policisë dhe rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit S. P.

b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin e datës 20.3.2018²¹, ka vendosur “Pranimin e kërkesës së prokurorisë për dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. *** të vitit 2017 në ngarkim të të pandehurit S. P., për veprën penale ‘kundërshtim i punonjësit të policisë dhe rendit publik’, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal”.

c. Çështja për gjykim themeli i është caktuar gjyqtares Luljeta Kole, e cila caktoi seancën gjyqësore me datë 13.4.2018 dhe shpalljen e vendimit me datë 27.4.2018. Prokuroria, në diskutimet përfundimtare, ka kërkuar “*Deklarimin fajtor të të pandehurit S. P. për kryerjen e veprës penale ‘kundërshtim i punonjësit të policisë dhe rendit publik’, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim. Sugjeron aplikimin e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, ku të pandehurit t’i zbritet 1/3 e dënimit si përfitim ligjor nga gjykimi i shkurtuar*”.

d. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin e datës 27.4.2018²², nga subjekti Luljeta Kole, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit S. P. për kryerjen e veprës penale ‘kundërshtim i punonjësit të policisë dhe rendit publik’, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 300,000 lekë gjobë. Në aplikim

²⁰Gjykata e Rrethit Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2022.

²¹Vendim nr.***, datë 20.3.2018.

²²Vendim nr.***, datë 27.4.2018.

të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit t'i zbritet 1/3 e dënimit si përfitim ligjor, duke u dënuar përfundimisht me 200,000 gjobë”.

Në vendim, subjekti Luljeta Kole ka arsyetuar se: *“Në individualizimin e dënimit për të pandehurin S. P., gjykata mban parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për të cilën ai duhet të deklarohet fajtor e shprehur edhe në marzhet e dënimit (paragrafi i dytë parashikon dënimin me gjobë ose me burgim gjer në 7 vjet), rrethanat e kryerjes së veprës penale, faktin që nga konsumimi i kësaj vepre nuk ka pasur ndonjë pasojë përveç cenimit të autoritetit të punonjësit të policisë, rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit i cili rezulton të jetë i dënuar më parë, qëndrimin e tij pohues dhe pendues gjatë hetimit dhe në gjykim. Duke vlerësuar elementët si më sipër, Gjykata çmon se qëllimet e dënimit penal që janë rehabilitimi i të pandehurit, parandalimi i veprimtarisë së kundërligjshme, por edhe ndëshkimi i tij për veprën penale të konsumuar i shërben edhe lloji i dënimit me gjobë sa kohë që dispozita parashikon edhe këtë masë dënimi krahas atij me burgim”.*

e. Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka ushtruar ankim prokurori i çështjes në Gjykatën e Apelit Korçë, i cili kërkon ndryshimin e vendimit dhe dënimin e të pandehurit S. P. me 1 vit burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e të pandehurit me 8 muaj burgim.

f. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ***, datë 1.11.2018, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 27.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për sa i përket deklarimit fajtor të të pandehurit S. P. për veprën penale ‘kundërshtim i punonjësit të policisë dhe rendit publik’, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal. Ndryshimin e këtij vendimi, për sa i përket llojit të dënimit duke e dënuar me 1 vit burgim dhe në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i ulet dënimi me 1/3, duke u dënuar përfundimisht me 8 muaj burgim”.

Gjykata e Apelit Korçë, në vendimin e saj, ka arsyetuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka caktuar një dënim të butë, duke mos zbatuar drejt ligjin penal, konkretisht nenin 47 të Kodit Penal dhe parimin e individualizimit të dënimit dhe kjo pasi masa e dënimit për të pandehurin S. P. nuk është në përshtatje me rëndësinë e faktit penal, me rrezikshmërinë e veprës penale dhe autorit, shkallën e fajit, rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parashikuara në Kodin Penal, duke caktuar një dënim që nuk i përgjigjet marzheve të dënimit që parashikon dispozita material e parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, dënim me gjobë dhe në alternativë dënim deri në 7 vjet burgim. Gjykata nuk ka vlerësuar drejt shkallën e veprimeve të paligjshme të të pandehurit në raport me rëndësinë e faktit penal²³, personalitetin e të pandehurit²⁴.

Gjykata e Apelit çmon se masa e dënimit e kërkuar nga prokurori është plotësisht në përputhje me qëllimin e dënimit, parandalimin e posaçëm dhe të përgjithshëm, si dhe rehabilitimin e të pandehurit.

g. Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit të dosjes gjyqësore, ndër të tjera, ka konstatuar se:

²³Rezultatet e hetimit administrativ, dërguar subjektit nga Komisioni.

²⁴Rezulton se i pandehuri është dënuar edhe dy herë të tjera më parë për veprat penale “deklarim të rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore”, “kanosje” dhe “mbajtje të armëve, bombave apo minave e lëndëve plasëse pa lejen e organeve shtetërore”, që tregon për një person me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

- Në lidhje me verifikimin e automjetit tip “Mercedes-Benz”, i cili rezultoi të kishte targat *** (ku nga verifikimi në DPSHTRR-së nga prokuroria rezultuan që ishin targat e një mjeti tip “Alfa Romeo” po në pronësi të të pandehurit), nuk janë kryer veprime nga subjekti Luljeta Kole gjatë procesit, pasi nuk ka pasur pretendime nga organi i akuzës, si dhe veprime të tilla kryhen nga gjyqtari i seancës paraprake në përputhje me kreun IX “Seanca paraprake” të Kodit të Procedurës Penale me ndryshimet e ligjit nr. 35/2017.

h. Në përcaktimin e masës së dënimit nga dënim me burgim i kërkuar nga prokurori i çështjes, në dënim me gjobë, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, nuk ka marrë parasysh faktin se:

- i) i pandehuri ka qenë dënuar edhe dy herë të tjera për veprat penale “deklarim të rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore”, “kanosje” dhe “mbajtje të armëve, bombave apo minave e lëndëve plasëse pa lejen e organeve shtetërore” si vepra penale jo pak të rrezikshme;
- ii) sjellja e të pandehurit në momentin e kontaktit me oficerët e policisë, mënyra se si ai është larguar nga vendi ku është ndaluar nga forcat e policisë, tregon që ka tendencë kriminale;
- iii) vepra penale e parashikuar nga neni 236/II i Kodit Penal, që në paragrafin e dytë përcakton si dënim deri në 7 vjet;
- iv) gjykata nuk ka vlerësuar drejt shkallën e veprimeve të paligjshme të të pandehurit në raport me rëndësinë e faktit penal;
- v) dënimet e mëparshme nuk kanë sjellë efekt edukativ tek i pandehuri;
- vi) masa e dënimit për të pandehurin nuk është në përshtatje me rëndësinë e faktit penal, me rrezikshmërinë e veprës penale dhe autorit, shkallën e fajit, rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parashikuara në Kodin Penal, duke caktuar një dënim që nuk i përgjigjet marzheve të dënimit që parashikon dispozita material e parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, dënim me gjobë dhe në alternativë dënim deri në 7 vjet burgim.

6.2 Komisioni, për sa më sipër, ka konstatuar se: (i) nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është individualizuar drejt masa e dënimit, në përputhje me kriteret e nenit 47 të Kodit Penal referuar rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit, shkallën e fajit dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese; dhe (ii) duket se subjekti i rivlerësimit (në pozicionin e gjyqtarës së çështjes) ka favorizuar pozitën e të pandehurit në drejtim të masës së dënimit, duke i dhënë dënimin më të lehtë të mundshëm.

Për konstatimet e mësipërme, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime për provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar se si gjyqtare ndan mendim të ndryshëm nga ai i Gjykatës së Apelit, duke argumentuar të gjitha faktet dhe rrethanat e lidhura me konsumimin e elementeve të veprës penale nga i pandehuri, sikurse edhe në lidhje me llojin dhe masën e dënimit që duhej dhënë.

Lidhur me faktin penal dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur vepra, subjekti ka shpjeguar të gjitha rrethanat se si ka ndodhur ngjarja²⁵.

²⁵Për detaje shihni prapësimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit që ndodhen në dosje.

Lidhur me vlerësimin e shkallës së veprimeve të paligjshme të të pandehurit në raport me rëndësinë e faktit penal, në vendimin e gjykatës është arsyetuar se nga ana objektive vepra penale “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik” kryhet me veprim aktiv që qëndron në kundërshtimin që i bëhet punonjësit të policisë së rendit publik, duke e penguar për të kryer detyrën sipas ligjit etj.

Në lidhje me individualizimin e dënimit për të pandehurin S. P., është arsyetuar në vendim se është mbajtur parasysh si rrezikshmëria shoqërore e veprës penale ashtu edhe ajo e autorit, sikurse edhe rrethanat rënduese dhe lehtësuese, sipas parashikimit të nenit 47 të Kodit Penal.

Rrezikshmëria shoqërore e veprës duhet parë jo vetëm në marzhet e dënimit që parashikon dispozita, por edhe e lidhur ngushtë me rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe faktin që nuk është përdorur dhunë fizike e mirëfilltë (goditje me grusht apo sende të tjera, kapje apo shtyrje, dëmtime/grisje të uniformës policore etj.), por kemi të bëjmë vetëm me “dhunë verbale”, ku nga konsumimi i kësaj vepre nuk ka ardhur ndonjë pasojë përveç cenimit të autoritetit të punonjësit të policisë.

Ndryshe nga sa përmend Gjykata e Apelit për “heqje zvarrë të policit”, nga asnjë akt i dosjes apo fashikullit të hetimit nuk rezulton një rrethanë e tillë. Përkundrazi, gjatë ripyetjes si deklarues disa ditë më vonë, shtetasi A. Sh. nuk ka përmendur faktin që është rrëzuar, por ka shpjeguar se *S. kur ka ndezur makinën nuk e kishte parë që ai kishte hapur derën dhe donte të hipte në makinë dhe se kolegët e tij e kishin tërhequr nga dera për të mos e kapur makina.*

Në lidhje me rrezikshmërinë shoqërore të personit është mbajtur parasysh jo vetëm fakti që ky person ka qenë edhe dy herë të tjera i dënuar, por edhe veprat penale për të cilat ky person është dënuar (“deklarim i rremë para oficerit të policisë gjyqësore”, “kanosje” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”), dënimi që gjykata ka caktuar për këto vepra (që ka qenë një dënim afër minimumit të parashikuar nga dispozitat përkatëse, pra nuk është evidentuar edhe prej tyre ndonjë rrezikshmëri tepër e lartë e autorit), si dhe fakti që nuk kemi të bëjmë me një të dënuar recidivist të posaçëm me precedent penal të një fushe të caktuar (sikurse në krime kundër jetës, shëndetit, narkotikëve, vjedhjeve etj.).

Përveç kësaj, në rastin konkret nuk është proceduar as me arrestim në flagrancë të këtij shtetasi nga oficerët e policisë gjyqësore dhe as nuk është kërkuar caktimi i ndonjë mase sigurimi ndaj tij nga ana e prokurorit, gjë që tregon se edhe vetë organi procedues nuk ka vlerësuar se kemi të bëjmë me rrezikshmëri të lartë të personit në raport me faktin penal dhe rrethana të tjera.

Po ashtu, në lidhje me argumentimin e Gjykatës së Apelit se dënimet e mëparshme nuk kanë sjellë efektin e tyre edukativ, subjekti shpjegon se çdo lloj dhe masë dënimi, si ai me burgim, ashtu edhe ai me gjobë, apo dënimet e tjera alternative të parashikuara në Kodin Penal, kanë për qëllim jo vetëm ndëshkimin e autorit për veprën e kryer, por edhe rehabilitimin e tij për të mos kryer vepra të tjera në të ardhmen. Nga ana tjetër, ky rehabilitim nuk mund të realizohet vetëm duke qenë i izoluar brenda ambienteve ku vuhën dënimet me burgim, por një rol të rëndësishëm kanë edhe institucionet e tjera ligjzbatuese dhe vetë shoqëria në përgjithësi.

Është mbajtur parasysh gjithashtu se e vetmja rrethanë rënduese në këtë rast ka qenë fakti që i pandehuri është i dënuar më parë (neni 50, germa “ç” e Kodit Penal), ndërkohë që jemi para disa rrethanave të tjera lehtësuese të parashikuara nga neni 48, gerrat “ç”, “dh” dhe “e” të

Kodit Penal, sikurse janë pendimi i thellë i treguar nga i pandehuri që në momentet e para të ngjarjes e në vazhdim të hetimit dhe në gjykim; fakti që personi është paraqitur vetë në Komisionin e Policisë menjëherë pas kryerjes së veprës; fakti që marrëdhëniet e tij me punonjësit e policisë janë normalizuar dhe ai ju ka kërkuar falje për veprimet e kryera; fakti që veprimet e tij lidhen me një gjendje të rënduar psikologjike për shkak se ka pasur një familjar të sëmurë në shtëpi të cilit duhet t'i çonte mjekimet që kishte blerë në farmaci, sikurse edhe frika apo presioni që mund t'i jetë shkaktuar nga prania e shtuar e forcave të policisë në vendin e ngjarjes.

Pavarësisht se Gjykata e Apelit është gjykatë e një shkalle më të lartë dhe ka të drejtë të cenojë vendimet gjyqësore të gjykatave të shkallës më të ulët, në analizë tërësore të rrethanave të mësipërme, subjekti vlerëson se dënimi i aplikuar nga gjykata në rastin e të pandehurit S. P. ka qenë objektiv, lloji dhe masa e dënimit janë individualizuar drejt dhe në përputhje me kriteret e nenit 47 të Kodit Penal dhe se nuk ka pasur si qëllim favorizimin e të pandehurit, duke kërkuar që Komisioni, veç sa më lart, të mbajë në konsideratë edhe bindjen e brendshme të gjyqtarit në këtë vendimarrje.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

Komisioni, pasi mori në analizë dosjen përkatëse, të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me çështjen në fjalë, i konsideron të mjaftueshme shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit. Nga ana e subjektit janë analizuar rrethanat e kryerjes së veprës penale, shkalla e rrezikshmërisë, personaliteti i të pandehurit, rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. Subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar dhe ka mbështetur kërkesën e prokurorisë në lidhje me cilësimin e veprës penale, duke e argumentuar drejt në vendimin e saj. Ndërsa në lidhje me masën e dënimit, subjekti ka shpjeguar se ndan qëndrim ndryshe në lidhje me individualizimin e dënimit, pra në dhënien e masës së tij, duke e argumentuar në mënyrë të detajuar vendimin e saj.

Komisioni, për sa i përket aspektit procedural të gjykimit të çështjes të cilat i ka analizuar më sipër, nuk ka konstatuar problematika lidhur me caktimin e seancave të gjykimit, kohëzgjatjen e gjykimit apo dhe dorëzimin e dosjes dhe vendimit brenda afateve të caktuara pranë sekretarisë gjyqësore, pra aspekte procedurale që janë edhe objekt verifikimi nga Komisioni. Ndërsa në lidhje me individualizimin e dënimit ku subjekti ndan qëndrim ndryshe nga analiza dhe vendimarrja e Gjykatës së Apelit, duke e argumentuar me hollësi qëndrimin e saj, Komisioni vlerëson se kjo pjesë i përket bindjes së brendshme të subjektit të rivlerësimit, për të cilën Komisioni mban parasysh nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, ku vlerësimi bazohet pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit.

Komisioni, bazuar në hetimin administrativ dhe shpjegimet e subjektit, arriti në përfundimin se të dhënat e referuara nga organet ligjzbatuese nuk provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo dhe kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë).

Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke

konfirmuar kështu përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Luljeta Kole.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

7. Procesi i rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 10.9.2020, për subjektin e rivlerësimit Luljeta Kole.

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotësuar me saktësi sipas shtojcës së ligjit.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti 1 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 11.4.2014²⁶. Në këtë çështje subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Në përfundim të gjykimit gjykata ka vendosur “Rrëzimin e kërkesëpadisë që i përket paditësit Th. Sh., si të pabazuar në prova e në ligj”. Vendimi i mësipërm është ankimuar nga palët në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 16.10.2014, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 11.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”.

Dokumenti 2 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 17.0.2015²⁷. Në këtë çështje subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Në përfundim të gjykimit gjykata ka vendosur “Pranimin e kërkesës së palës kërkuese D. B. dhe G. B.. Lejimin e birësimit të të miturës R. O...”. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga asnjëra palë.

Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLGJ-së dhe pas analizimit të dokumenteve 1 dhe 2, nuk konstatohen problematika lidhur me kriterin profesional.

Dokumenti 3 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 26.02.2016, që i përket çështjes civile me palë: kërkues A. Sh. dhe N. Sh.; person i tretë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë; objekti “Heqja e zotësisë për të vepruar për A. Sh. dhe për bashkëshorten e tij H. Sh., dhe vendosjen e A. Sh. si kujdestarin e tyre ligjor. Vendosjen e N. Sh. si kujdestare ligjore të fëmijëve të mitur

²⁶Që i përket çështjes civile me palë: paditësit Th. Sh., kundër të paditurve Komuna ***, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, me objekt “Detyrim i Komunës Drenovë të njohë paditësin pronar në pasurinë nr. ***, z. k. ***, detyrimin e ZVRPP-së Korçë të bëjë regjistrimin e kontratës së shitjes për pasurinë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, datë 14.7.2010, të Këshillit të Ministrave”.

²⁷Që i përket çështjes civile me palë: kërkuesve D. B., G. B.; persona të tretë: Komiteti Shqiptar i Birësimit dhe Shtëpia e Foshnjës “***” Korçë, me objekt “Birësim”.

F. Sh., i datëlindjes 17.7.2002 dhe Dh. Sh. i datëlindjes 12.12.2003”. Kjo çështje u gjykua nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte kryesuese.

Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur “Pranimin e pjesshëm të kërkesës së kërkuësve A. Sh. dhe N. Sh. Kufizimin e zotësisë për të vepruar të shtetasit A. Sh.”. Vendimi i mësipërm mori formë të prerë pa u ankimuar nga asnjëra palë.

Komisioni, bazuar në raportin e KLGJ-së dhe pas analizimit të dokumentacionit në dosje, ka konstatuar se: “Gjykimi i çështjes ka zgjatur 9 muaj në intervalin kohor 26.5.2015 – 26.2.2016, në shkelje të afatit kohor standard 6-mujor të parashikuar nga neni 5, germa ‘e’ e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit”.

Për konstatimin e mësipërm subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në prapësimet e saj pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se çështja është regjistruar në datën 26.5.2015 dhe i ka rënë në short gjyqtarës M. M., e cila ka zhvilluar disa seanca. Për shkak se kjo gjyqtare u largua në një detyrë tjetër, në datë 23.7.2015 kjo çështje u rishortua dhe iu caktua për gjykim subjektit Luljeta Kole. Janë zhvilluar 10 seanca gjyqësore deri në përfundim të çështjes²⁸. Përveç kompleksitetit të çështjes, subjekti shpjegon se në asnjë rast seancat nuk janë shtyrë për shkaqe që lidhen me gjykatën, por për shkaqe ligjore procedurale apo kërkesa të vetë palëve për shtyrje referuar të drejtave procedurale që ju njeh ligji (përfaqësimi në gjykim me avokat, përgatitja e pretendimeve përfundimtare me shkrim etj.), si dhe mosparaqitja e palëve ose ekspertëve. Edhe në rastet e shtyrjes së seancës, gjykata ka marrë masa që seanca gjyqësore të shtyhet në një afat sa më të shkurtër.

Subjekti thekson se në analizën tërësore të rrethanave të mësipërme arsyet e tejkalimit të afatit ligjor kanë qenë objektive.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet të plota dhe bindëse. Bazuar në shpjegimet e subjektit rezultoi se kohëzgjatja e gjykimit të kësaj çështjeje jashtë afatit të parashikuar ligjor nuk ka ardhur si pasojë e veprimeve të subjektit në cilësinë e gjyqtarës së çështjes, por ka ardhur nga vetë palët në gjykim, pra për shkaqe objektive të pavarura nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të kësaj çështjeje nuk ka ardhur si pasojë e veprimeve të subjektit por shkaqe të natyrës objektive (nga palët në gjykim). Në këtë rast subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore për sa i përket aspektit profesional.

Pesë dokumentet ligjore të përzgjedhur me short

Dosja 1 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 5.11.2013 regjistrimi²⁹. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 1.10.2013. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si

²⁸Shihni në dosje prapësimet e detajuara të subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni.

²⁹Që ju përket palëve: paditësit I. L., kundër të paditurve përmbauesit gjyqësor privat A. K. dhe I. K., me objekt “Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv (deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.8.2012). Kundërshtim i veprimeve të përmbauesit gjyqësor nr. ***

gjqtare e vetme dhe ka vendosur “Pranimin e kërkesëpadisë. Deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv, deklaratë noteriale ..., hartuar nga noter K. M. Anulimin e veprimeve përmbarimore të kryera nga përmbaruesi gjyqësor privat...”.

Ndaj vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Korçë i padituri, përmbaruesi privat A. K., i cila me vendimin nr. ***, datë 16.7.2014, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 13.2.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë”. Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë i padituri, përmbaruesi privat A. K. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 17.11.2017, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur, përmbaruesi gjyqësor privat A. K.”.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 3 muaj e 2 ditë. Rezulton se gjykimi është realizuar në respektim të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja 2 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 9.4.2014 regjistrimi³⁰, e përfunduar me vendimin nr. *** datë 24.9.2014. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme dhe ka vendosur “Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurës I. L. që të lirojë e dorëzojë në favor të paditësit S. L. një apartament banimi të ndodhur në ***”.

Ndaj vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Korçë e paditura I. L., duke kërkuar prishjen e vendimit dhe rrëzimin e padisë. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ***, datë 9.4.2015, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 24.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”. Ndaj vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Korçë ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë e paditura, por rekursi ende nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 5 muaj e 15 ditë, në respektim të afatit standard 6-mujor. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja 3 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 30.3.2016 regjistrimi³¹, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.4.2016. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme dhe ka vendosur “Pranimin e kërkesëpadisë. Lëshimin e urdhrin të mbrojtjes ndaj shtetases A. A. dhe fëmijëve të saj A. A. e K. A., ndaj të paditurit F. A.”. Vendimi është i formës së prerë.

Gjykimi i çështjes ka përfunduar brenda 24 orëve nga regjistrimi i saj. Kohëzgjatja e gjykimit është në respektim të afatit standard prej 48 orësh të përcaktuar nga ligji nr. 9669, datë 17.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja 4 – çështja civile familjare nr. *** regjistri themeltar, datë 3.2.2015 regjistrimi³², e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 1.4.2015. Subjekti ka gjykuar si gjyqtare e vetme dhe ka

regj., datë 30.10.2013 ‘Lajmërim për ekzekutim vullnetar’, marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar veprimet përmbarimore”.

³⁰Që ju përket palëve: paditësit S. L. kundër të paditurit I. L., me objekt “Detyrimi i të paditurës I. L., të më lirojë dhe dorëzojë pasurinë nr. ***”.

³¹Që ju përket palëve: paditëses A. A. kundër të paditurit F. A., me objekt “Lëshim i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes”.

³²Që ju përket palëve: paditëses A. D. kundër të paditurit A. S., me objekt “Zgjidhje martesë, lënie për rritje dhe edukim fëmijët e mitura S. S. e S. S. mua paditëses, përcaktim detyrim ushqimor në vlerën prej 10,000 lekë për secilin fëmijë dhe detyrimin e sigurimit të banesës për mua dhe fëmijët”.

vendosur “Zgjidhjen e martesës ligjore lidhur në datën 27.5.2001, midis paditëses A. D. dhe të paditurit A. S.”. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 muaj e 29 ditë, në respektim të afatit standard 4-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja 5 – çështja penale nr. *** regjistrimi, datë 24.5.2016 regjistrimi³³, çështje e përfunduar me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 8.6.2016 ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit Gj. G., për veprën penale ‘mashttrim në sigurime’, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 300.000 lekë gjobë. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit i zbritet si përfitim ligjor 1/3 e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 200.000 lekë gjobë”. Rezultoi se vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë pa u kundërshtuar nga asnjëra palë.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 15 ditë, në respektim të afatit standard 9-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLGJ-së, si dhe nga analizimi i dokumentacionit në pesë dosjet, nuk konstatohen problematika për sa i përket kriterit profesional.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Luljeta Kole janë paraqitur 5 ankesa (2 të vitit 2013 dhe 3 të vitit 2014) në Inspektoratin e KLD-së. Dy ankesa të vitit 2013 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, pasi pretendimet për ligjshmëri vendimi zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

Ndërsa, për tri ankesa të vitit 2014 të verifikuara, vetëm për një prej tyre ku pretendohet zvarritje gjykimi, pas verifikimit i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi etik dhe profesional (mangësi profesionale), pasi nuk kanë rezultuar shkelje disipline. Dy ankesat e tjera rezultuan pa probleme.

Komisioni ka administruar përgjigjen e KLGJ-së³⁴, e cila konfirmon se lidhur me praktikën e hetimit disiplinor, filluar me vendim datë 26.4.2017, të Inspektoratit të ish-KLD-së, rezulton se në datën 19.12.2018, me vendimin nr. *** prot., nga Inspektorati është vendosur pezullimi i hetimit disiplinor nr. ***, datë 26.4.2017, ndaj subjektit Luljeta Kole, pasi çështja është në gjykim në Gjykatën e Lartë. Praktika është dërguar për trajtim pranë ILD-së me shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2021.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Luljeta Kole, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-KLD ndonjë masë për procedim disiplinor.

Në raportin e KLGJ-së për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar aftësi të mira: (a) profesionale (njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor); (b) organizative (aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore dhe aftësia për të administruar

³³Në ngarkim të të pandehurit Gj. G., i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë për kryerjen e veprës penale “mashttrim në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal.

³⁴Përgjigje nr. *** prot., datë 21.7.2022, e KLGJ-së.

dosjet); (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale (etika në punë dhe integriteti); dhe (d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional (aftësia e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar dhe gatishmëria për t'u angazhuar).

Të dhëna nga prokuroritë për kallëzime/procedime penale

Prokuroritë e rretheve gjyqësore³⁵ kanë konfirmuar se pranë tyre nuk rezultojnë të ketë procedime penale të mosfilluara/pushuara/pezulluara apo të dërguara për gjykim për subjektin e rivlerësimit Luljeta Kole.

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë³⁶ konfirmon se në emër të subjektit Luljeta Kole nuk rezultojnë që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Prokuroria e Përgjithshme³⁷ konfirmon se ndaj subjektit Luljeta Kole nuk rezultojnë të ketë çështje penale të regjistruara në ngarkim të saj.

Denoncimet/ankesat nga publiku

Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar 8 denoncime/ankesa nga publiku.

i) Denoncim nr. * prot., datë 19.12.2017, i shtetases N. Ll.,** e cila pretendon për vendim të padrejtë, favorizim të palës tjetër dhe zvarritje procesi nga subjekti Luljeta Kole.

Komisioni ka administruar nga Gjykata e Lartë³⁸ e cila ka përcjellë pjesën e dosjes gjyqësore për gjykimin në shkallë të parë gjykuar nga subjekti Luljeta Kole për të verifikuar pretendimet e denoncuesit. *Nga analizimi i dokumentacionit nga ana e Komisionit rezultoi se nuk ka indicie apo prova për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.*

ii) Denoncim nr. * prot., datë 23.1.2018, i shtetasit S. D.,** i cili pretendon për shkelje administrative nga ana e administratës së gjykatës, për të cilën nuk ka lidhje me subjektin e rivlerësimit Luljeta Kole.

Denoncuesi nuk ka bashkëlidhur asnjë dokument provues në lidhje me pretendimin e tij. Komisioni vëren se pretendimi i subjektit ka të bëjë me çështje administrative të gjykatës, të cilat nuk janë objekt shqyrtimi i Komisionit.

iii) Denoncim nr. * prot., datë 23.1.2018, i shtetasit S. D.,** i cili pretendon për zvarritje në proces, mosshpallje e vendimit të datës 9.1.2018, duke i mohuar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit.

Ky denoncim është i njëjtë me denoncimin e analizuar në vijim, të shtetasit M. D..

iv) Denoncim nr. * prot., datë 8.2.2019, i shtetasit M. D.,** i cili pretendon për vendim të padrejtë, të njëanshëm dhe joprofesional, duke mbuluar shkeljet e bëra nga kolegët dhe

³⁵Shkresat e prokurorive të rretheve gjyqësore: Tropojë, me nr. *** prot., datë 6.7.2022; Berat, me nr. *** prot., datë 8.7.2022; Korçë, me nr. *** prot., datë 8.7.2022; Kurbin, me nr. *** prot., datë 12.7.2022; Elbasan, me nr. *** prot., datë 13.7.2022; Krujë, me nr. *** prot., datë 8.7.2022; Lezhë, me nr. *** prot., datë 12.7.2022; Fier, me nr. *** prot., datë 13.7.2022; Vlorë, me nr. *** prot., datë 13.7.2022; Dibër, me nr. *** prot., datë 13.7.2022; Pogradec, nr. *** prot., datë 15.7.2022; Sarandë, me nr. *** prot., datë 12.7.2022; Kukës, me nr. *** prot., datë 14.7.2022; Mat, me nr. *** prot., datë 13.7.2022; Durrës, me nr. *** prot., datë 18.7.2022; Kavajë, me nr. *** prot., datë 20.7.2022; Lushnjë, me nr. *** prot., datë 21.7.2022; Tiranë, me nr. *** prot., datë 27.7.2022; Shkodër, me nr. *** prot., datë 29.7.2022; Pukë, me nr. *** prot., datë 28.7.2022.

³⁶Shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2022, e PPKKKO-së.

³⁷Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2022, e Prokurorisë së Përgjithshme.

³⁸Shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2022, e Gjykatës së Lartë.

nëpunësit e gjykatës. Denoncuesi ka bashkëlidhur korrespondencën e zhvilluar me kryetarin e gjykatës, dispozitiv vendimi të gjyqtares I. P., kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. *** etj.

Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë³⁹ dosjen gjyqësore me numër vendimi ***, që i referohet kërkesës për pushimin e çështjes penale nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Komisioni vëren se pas analizimit të dokumentacionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, pas shqyrtimit të çështjes, me vendimin e datës 9.1.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e çështjes penale për kallëzimin e bërë nga denoncuesi M. D.. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin e datës 1.3.2018.

Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit, arriti në përfundimin se nuk u konstatuan *indicie* apo prova për ta ngarkuar subjektin nga e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, për sa i përket kriterit profesional.

v) Denoncimet nr. * prot., datë 26.1.2018, nr. *** prot., datë 2.2.2018 dhe nr. *** prot., datë 1.7.2019, të shtetases Xh. Q., e cila ngre ankesë për subjektin e rivlerësimit për rrëzimin e kërkesës së saj kundër vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.**

Komisioni vëren se pas analizimit të dokumentacionit të depozituar nga denoncuesja rezulton se nga organi i prokurorisë është vendosur pushimi i çështjes penale të shpërdorimit të detyrës për kallëzimin e bërë nga denoncuesja ndaj ekspertëve të IML-së për një aktekspertimi. Ndaj vendimit të prokurorisë denoncuesja ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e gjykuar nga subjekti Luljeta Kole, e cila, me vendimin e datës 4.1.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetases Xh. Q.. Ndaj këtij vendimi të subjektit, denoncuesja ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila, me vendimin e datës 30.3.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga subjekti, duke e rrëzuar përfundimisht kërkesën e denoncueses Xh. Q.

Gjykata e Apelit Korçë e gjen tërësisht ligjor arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ndërsa ankimi i paraqitur nga ankuesja Xh. Q. nuk përmban asnjë shkak ligjor që të sjellë pasojë ndryshimin e vendimit objekt ankimi dhe prishjen e vendimit të pushimit të organit të prokurorisë.

Komisioni vëren se denoncimi i shtetases Xh. Q. lidhet me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, për të cilën Komisioni mban parasysh nenin 73 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, vlerëson se nuk ka *indicie* apo prova që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin profesional.

vi) Denoncim nr. * prot., datë 21.3.2019. i shtetasit M. G., i cili pretendon nga disa subjekte, përfshirë edhe subjektin Luljeta Kole, për vendime të padrejta, zvarritje në proces etj.**

Komisioni vëren se denoncuesi nuk ka referuar ndonjë të dhënë konkrete ndaj subjektit të rivlerësimit. Denoncimi i shtetasit M. G. nuk plotëson kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi denoncuesi nuk ka referuar rrethana konkrete, praktika apo veprime specifike të subjektit të rivlerësimit.

³⁹Shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nr.*** prot, datë 6.7.2022

Komisioni, në përfundim të hetimit, pasi mori në analizë të gjitha denoncimet, faktet dhe rrethanat e pasqyruara në to, si dhe veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit deri në vendimmarrje, nuk konstatoi elemente që e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi disiplinore për sa i përket kriterit profesional.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Luljeta Kole:

a) Ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal, të cilat konsiderohen si pasaktësi që nuk kanë pasur për qëllim fshehje pasurie.

Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti, kanë ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara.

b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Luljeta Kole ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Luljeta Kole, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 21.10.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj